


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORATI

Nr. 694 Prot.

Gjirokastrë, më 18.04.2025

Lënda: Hapet thirrja për aplikime për pjesëmarrje në Javën Ndërkombëtare të organizuar nga Universiteti Goluchowski, Poloni në kuadër të programit Erasmus+

Universiteti Goluchowski zhvillon në datat 11 - 15 maj 2025, Javën Ndërkombëtare të Stafit në kuadër të programit Erasmus+, me pjesëmarrjen e partnerëve nga institucione të ndryshme ndërkombëtare.

Universiteti i Gjirokastrës do të përfaqësohet në këtë aktivitet nga 4 anëtarë të stafit akademik, pjesë e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Fakultetit Ekonomik.


Të interesuarit duhet të dorëzojnë dorazi pranë Sektorit të Koordinimit Ndërkombëtar, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor, ose elektronikisht në adresën iro@uogj.edu.al, brenda datës **25.04.2025** dokumentacionin, si vijon:

- Vërtetim punësimi;
- Letër Interesi në anglisht;
- CV në formatin EUROPASS në anglisht;
- Çertifikatë të njohurive të gjuhës angleze në nivelin B2;
- Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit.

Dokumentacioni juaj do të vlerësohet paraprakisht nga një komision *ad hoc* i ngritur pranë UGJ-së dhe më pas Sektori i Koordinimit Ndërkombëtar, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor do t'ia përcjellë nominimet Universitetit Goluchowski në Poloni, për vlerësimin përfundimtar të aplikantëve të cilët do të përzgjidhen.

Zv/Rektore për Koordinimin Ndërkombëtar dhe Kërkimin Shkencor

Prof. asoc. Merita Isaraj



Konceptoi: Irma Gjolleshi

